



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 38/08

Prishtinë, më 16.12.2008, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Naser Osmani.

Anëtarët jo të pranishëm: Riza Smaka.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Nekibe Kelmendi Ministresh e Ministrisë së Drejtësisë, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të organizatave buxhetore që kanë të bëjnë me Projektligjin nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
- 3. Të ndryshme**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2.1. Shqyrtimi buxhetit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit

Kryesuesi, kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e këtij agjencioni lidhur me kërkesën e tyre.

Avni Jashari, njoftoi se pas konsultimeve të bëra në mes Komisionit dhe MEF-it, kanë arritur të zvogëlojnë kërkesën buxhetore, ndër të cilat edhe kërkesën për auditimin, të cilën detyrë janë pajtuar që ta kryej Zyra e Auditorit Gjeneral.

Agim Krasniqi, njoftoi se edhe MEF-i ka ardhur me propozime të reja. Për paga dhe mëditje 150.000€ Mallra dhe Shërbime 382.000€ Subvencione dhe Transfere 100.000€ për Auditimin 166.000€ Gjithsejtë kërkesa shtesë e pranuar për MEF-in është afërsisht rreth 800.000€

Besa Gaxherri, duke ditur faktin se ky agjencion ka pasur një zë të keq sa i përket mundësisë së keqpërdorimeve dhe keqmenaxhimeve, është e papranueshme t'i shtohet buxheti. Madje sipas znj. Gaxherri edhe buxheti i paraparë nga Qeveria është i lartë dhe duhet zvogëluar.

Naser Osmani, theksoi se duke pasur parasysh çështjen bartjes së kompetencave dhe transformimit të agjencionit, të mos vije në shprehje besueshmëria e stafit të ri. Megjithatë duhet të kemi informata më të shumta për të marrur vendim të arsyeshëm.

Kryesuesi, pyeti përfaqësuesit e AKP-së se a ju mjaftojnë shumat e reja të propozuara nga MEF-i prej 800.000€deri në rishikim të buxhetit, mëpastaj varësisht prej rezultateve të shikohet mundësia e plotësimit të buxhetit, në mënyrë që mos të pengohet puna e këtij agjencioni.

Dino Asanaj, në përgjigjen e pyetjes së parashtruar, theksoi se edhe me shumën prej 800.000€ shtesë të buxhetit për gjashtë muajt e parë të vitit, AKP-ja nuk mund të funksionojë dhe të realizojë obligimet e parashikuara.

Haki Shatri, kërkoi që mos të lihet kjo kërkesë për rishikim por në bashkëpunim me MEF-i të shikohet mundësia e plotësimit të asaj qfarë është e arsyeshme.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, duke komentuar kërkesën theksoi se në bashkëbisedim me disa donatorë kemi marrë premtimin për ndarjen e disa veturave, e që do ti jepeshin AKP-së, si dhe disa tjera nga makinat e përdorura që posedon ministria. Me zbritjen e shumës së paraparë për makina, kërkesa e AKP-së do të zbritet afërsisht 1.000.000€që do të jetë e pranueshme për MEF-in.

Dino Asanaj, u pajtua me propozimin që të heqin dorë nga blerja e veturave dhe se të njëjtat të i sigurojë MEF-i.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet kërkesa e fundit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke zbritur edhe shumën e paraparë për blerjen e veturave dhe se obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave këtij agjencioni të sigurojë këto vetura.

2.2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë

Kryesuesi, ia dha fjalën Ministreshes znj. Nekibe Kelmendi, për të arsyetuar kërkesën e parashtruar.

Nekibe Kelmendi, Ministresh e MD, duke arsyetuar kërkesën, theksoi se tre propozimet e para janë çështje teknike, lëvizje të brendshme. Propozimi i katërt ka të bëjë me barazimin e statusit të oficerëve korrektues me policinë në çështjen e pagave. Propozimi tjetër ka të bëjë me ndërtimin e Burgut të Sigurisë së lartë. Në kuadër të kësaj Komisioni Evropian (përmes programit IPA) ka ndarë 3.00.000€ për ndërtimin e objektit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa Ministrisë i kërkohet të sigurojë 1.500.000€ Në këtë mënyrë kërkojmë që shumë prej 2.000.000€ të paraparë për këtë projekt në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike të bartet buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë (1.000.000 € për 2009 dhe 1.000.000€ për vitin 2010). Propozimi gjashtë dhe shtatë ka të bëjë me bartjen e kompetencave dhe në këtë mënyrë është rritur e numrit të punëtorëve në Departmanetin e Mjekësisë Ligjore për të bërë zbulimin e mbetjeve mortore. Propozimi i tetë ka të bëjë me blerjen e laboratorit për analizat e ADN-së. Qëllimi është krijimi i databazes për konstatimin e grupeve të gjakut të familjarëve të humbur, kur dihet se një analizë e tillë është nevojë urgjente dhe se ato po bëhen jashtë vendit dhe janë mjaft të kushtueshme. Ministresha bëri edhe një kërkesë të re për sigurimin e një automjeti të përdorur nga MEF-i për të mbikëqyrur pjesën e jashtme të burgut.

Haki Shatri, u pajtua me tri propozimet e para, pasi kemi të bëjmë me lëvizje të brendshme, gjithashtu mund të pranohet edhe bartja e mjeteve nga Gjykata Kushtetuese në objektin burgu i sigurisë së lartë. Ndërsa për propozimet tjera të shikohet mundësia e plotësimit të tyre.

Naser Osmani, lidhur me kërkesën për ngritje të pagave të oficerëve, theksoi se nëse janë të armatosur duhet barazuar me policinë.

Kosara Nikolic, u pajtua me mendimin që të bëhet nivelizimi i pagave të oficerëve korrektues me policinë sepse ka arsye për një nivelizim të këtillë.

Shkumbin Demaliaj, pasi që ligji për buxhetin ka fuqi më të madhe ligjore se vendimet e Qeverisë, kërkoi që Komisioni të rekomandoj Kuvendit për kërkesën e Ministrisë.

Safete Hadërgjonaj, duke iu përgjigjur parafolësit për fuqinë ligjore që ka Ligji i buxhetit, theksoi se me rastin e miratimit të tij nuk duhet shkelur ligjet tjera që janë bazë për këtë ligj (siç është Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë). Kërkesa është e arsyeshme por duhet respektuar baza ligjore.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, duke u ndërlidhur në debat, theksoi se këto çështje do të duhej të diskutoheshin dhe zgjidheshin brenda Qeverisë pas kemi të bëjë me kërkesat e dikastereve të ekzekutivit. Të shikohet mundësia e plotësimit të kërkesës brenda Qeverisë duke mos lëvizur kufijtë buxhetor. Lidhur me transferimi e mjeteve për ndërtimin e burgut të sigurisë së lartë, theksoi se kjo mund të bëhet, pasi kemi të bëjmë me lëvizje të brendshme buxhetore.

Xhevdet Neziraj, u pajtua me mendimet se këto çështje është dashur paraprakisht të zgjidhen brenda Qeverisë. Komisioni do të duhej të fokusohet më shumë në kërkesat e agjencioneve të pavarura.

Hajdin Abazi, theksoi se kemi të bëjë me një kërkesë të ndjeshme. Sidomos ndërtimi i laboratorit të ADN-së. Duhet shikuar mundësia që të krijimit të databazes për konstatimin e grupit të gjakut sepse paraqet një çështje të ndjeshme për shoqërinë dhe mungesa e tij po i kushton shumë buxhetit të Kosovës.

Kryesuesi, u pajtua me konstatimet se kërkesat janë të arsyeshme. Por duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë një kërkesë të një Ministrie që është pjesë e ekzekutivit, mundësia e plotësimit të bëhet brenda Qeverisë. Ndërsa përjashtimisht, Komisioni mund të pranohen kërkesat për lëvizje të brendshme buxhetore.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni shqyrtoi kërkesën e Ministrisë dhe pranoi tre propozimet e para që kanë të bëjnë me lëvizjet e brendshme buxhetore brenda buxhetit të kësaj Ministrie. Komisioni miratoi edhe kërkesën e katërt që ka të bëjë me transferimin e mjeteve të parapara për ndërtimin e objektit të Gjykatës Kushtetuese nga buxheti i Ministrisë së Shërbimeve Publike në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë në projektin, Ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë.

2.3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Pushtetit Lokal

Besnik Osmani, njoftoi se Ministria është dakord me buxhetin e ndarë, mirëpo kërkesa jonë konsiston në atë që kategoria e shpenzimeve kapitale në shumën prej 6.667.441€ të specifikohet sipas projekteve si në vijim: për grandin stimulues për komuna të ndahen 3.100.000€ në projektin pjesëmarrja e qeverisjes lokale në realizimin e projekteve të IPA-së në shumën prej 2.500.000€ për vazhdimin e projektit – rrejtji i MAPL në shumën prej 869.000€ ndërtimi i pesë zyrave të vendit në shumën prej 208.441€ Kemi të bëjmë me rialokimi të brendshme të projekteve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet kërkesa e Ministrisë së Administrimi të Pushtetit Lokal për rialokime të brendshme të mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale sipas projekteve të parapara me këtë kërkesë.

2.4. Shqyrtimi i kërkesës për shpërndarjen e granteve nga komunat e reja në Komunat amë

Petrit Popova, drejtor i departamentit të buxhetit komunal, kemi të bëjë me grantet e komunave të reja të paraparë për vitin 2009, por për shkak të pamundësisë së krijimit të tyre, në marrëveshje me ICO propozohet se këto mjete të shpërndahen komunave amë sipas kategorive ekonomike. Përjashtimisht njoftoi se një pjesë e grantit iu mbetet komunave të reja.

Haki Shatri, njoftoi se kemi një ankesë prej Komunës së Prishtinës për zvogëlimin e buxhetit të kësaj komune, lidhur me këtë kërkoi sqarime pse ka ndodhur ky reduktim.

Petrit Popova, departamentit të buxhetit komunal, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se Komisioni i veçantë ka përcaktuar ndarjet buxhetore për komunat me të cilat vendime nuk është pajtuar përfaqësuesit i Komunës së Prishtinës. Është lënë mundësia e rishqyrtimit të tyre në procesin e rishikimit të buxhetit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet kërkesa e departamentit të buxhetit komunal për shpërndarjen e granteve të komunave të reja në komunat amë.

2.5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë

Haki Shatri, njoftoi se kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë ka të bëjë me faktin se mjetet e lejuara nuk janë shpërndarë sipas kërkesës së tyre në kategorinë e caktuara ekonomike.

Agim Krasniqi, pasi që kemi të bëjmë me rregullime të brendshme, nëse kërkesa është mirë përgatitur, me vendimin e Kuvendit mund të bëhen këto rregullime të brendshme.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Të bëhet rregullimi i brendshëm i buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe paga dhe mëditje sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë.

2.6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Agim Krasniqi, njoftoi se kemi të bëjë me një shumë prej 11,344.500 € në emër të rritjes së pensioneve dhe duhet shpërndahen në programet ekzistuese.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet propozimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për shpërndarjen e mjeteve të përfituesve të pensioneve në programet ekzistuese.

3. Të ndryshme

Mufera Sinik, përsëriti kërkesën për ndërtimin e një aneksi në shkollën “Motrat Qiriazit”. Nevoja për ndërtimin e kësaj shkolle është urgjente për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe kushteve të këqija që ekzistojnë në këtë shkollë. Për të realizuar këtë nevojiten 200.000€

Haki Shatri, theksoi se ekziston një propozim për ndërtimin e një shkolle fillore në Bradash të Podujevës. Propozoi që për këtë shkollë dhe atë në Prizren në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Arsimit të parashihen nga 100.000€secilin.

Besa Gaxherri, kërkoi që çështja e ndërtimit të shkollave të rregullohet brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit në bazë të përcaktimit të prioritetëve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohen kërkesat për ndarjen e mjeteve shtesë në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndërtimin e aneksit të sh.f. “Motrat Qiriazit” në Prizren në shumën prej 100.000€dhe ndërtimi i sh.f. në Bradash në komunën e Podujevës në shumën prej 100.000€

Besa Gaxherri, kërkoi që Komisioni të rekomandoj Kuvendit që Ligji për Presidentin mos të kalojë në Kuvend pa miratimin e Ligjit për Deputetët.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI